

FJALA E DEPUTETIT XHEMAL QEFALIA

E ENJTE 12 MAJ 2022

Në fakt, është e vërtetë ajo që dha ministri, se shqetësimi më i madh i opozitës në tërësi janë patronazhistët. Zoti Ministër, unë dua t'ju falënderoj për mënyrën si po e qasni legjislacionin shqiptar me atë të shteteve të tjera homologe dhe të shteteve të BE-së! Sa për patronazhistët, kjo maxhorancë ka pasur një vullnet të mirë politik, që ju ka plotësuar dëshirën, ndryshe nga ju, kur ishit në maxhorancë, për ngritjen e një komisioni hetimor. U krijua komisioni hetimor, madje u vendosën edhe këto pika në detaje dhe ju e braktisët. E braktisët se nuk kishit interes, sepse e patë që nuk janë patronazhistët shkak i humbjes, janë arsye të tjera, që ju çuan në humbjen spektakolare në 2021-in.

A bëtë ju patronazhistë? Po, bëtë, madje me pasoja edhe më të mëdha. A ju kujtohet se çfarë bëtë në Elbasan? Krijuat grupe paramilitare të armatosura, me furgona, më shenja dalluese, dhe jo vetëm kaq, por e përçuat në të gjithë Shqipërinë. Doli dikush atje nga Veriu dhe tha të njëjtën gjë: vrasje, gjak, sepse kjo është filozofia e kësaj opozite. Ndaj, ne nuk kemi pse të shqetësohemi fare për këtë pjesë, pasi është një mundësi e mirë, sepse, ashtu siç e kanë ratifikuar rreth 17 vende, patjetër atë do ta bëjë edhe parlamenti shqiptar, madje edhe disa anëtarë komisionesh, si tek i Ligjeve, ashtu dhe tek i Sigurisë e kanë votuar dhe kanë bërë mirë. Shpresoj që t'i gjejme këto vota në kuti, pasi kjo i shërben sigurisë së të dhënave personale të shtetasve shqiptarë.

Kërkoj ndjesë, zonja Kryetare, se do të dal pak nga tema, pasi në seancën e kaluar një nga deputetët, madje disa nga deputetët e opozitës, të shqetësuar për problemet që kanë në shtëpinë e tyre, erdhën këtu dhe gjoja po u qanin hallet qytetarëve për shqetësimet që kanë në zonë. Ata erdhën këtu dhe përmendën emrat e fshatrave të zonës së Tiranës, sepse atyre u bëhet qejfi, se aq duan. Po si mund të shkosh në zonë, të prezantohesh, të bësh 2-3 foto, ta hedhësh në Facebook dhe të përmendësh fshatrat Murriz, Vilës, Zall-Bastar, Mner, të thuash njerëz të mrekullueshëm. Natyrisht, është një ndër zonat me njerëzit më të mirë, më punëtorë, që kurrë nuk e kanë shitur votën. Përkundrazi, ata janë bërë bashkë. Por ju nuk keni nga ta dini. Çfarë ndodh me një pjesë tuajën, them me një pjesë, se dëgjova një nga parafolësit të fliste për ligjin për barazinë gjinore, i cili i zuri vendin një deputeteje tjetër, erdhi këtu me 300 e ca vota? Po e vazhdoj idenë ku e kisha.

Ju i ndërroni zonat, pasi gënjeni në një zonë e në një tjetër, premtoni pa fund, shkoni atje dhe u qani hallin atyre njerëzve. Nuk i mashtroni dot. Mora zonën e Zall-Bastarit, një zonë e mrekullueshme e Tiranës, për t'u thënë atyre zotërinjve apo zonjave që shkojnë atje, ta shohin realitetin në sy. Unë kam shkuar në atë zonë kur Ministrinë e Arsimit e drejtonte Kryetarja e Kuvendit. Kam debatuar me të dhe i kam thënë: "Zonja Ministre, situata reale në këtë zonë është që mësuesi i fizikulturës jep kimi, mësuesi i muzikës jepte matematikën". Sot kjo nuk ndodh, se kjo maxhorancë e ka ndryshuar këtë. Deputeti nuk merret më me faktin që të caktojë se kush do të hyjë dhe kush do të dalë, por ka një portal.

E pra, ky është ndryshimi që është bërë. Është bërë ndryshimi në atë zonë jo vetëm në mënyrën se si është ndërtuar infrastruktura, por tashmë atje është vendosur edhe shërbimi urban, njësoj si në qendrën e Tiranës. Po shërbimi shëndetësor? Ka vajtur ministrja e Shëndetësisë disa herë atje dhe nuk ka vajtur për selfie, as për të bërë foto për t'i postuar në Facebook; ka inauguruar një ambulancë moderne, që do ta kishin zili edhe këtu, në qendrën e Tiranës. Është një mjek i shkëlqyer nga Tropoja atje, që quhet Bashkim Murati, një patriot i vërtetë, që e ka ngritur shërbimin shëndetësor 24 orë! E pra, kush e ka bërë? E ka bërë vullneti politik i kësaj maxhorancës. Po pse ka sukses dhe pse nuk i marrin votat? Nuk i marrin dot, sepse skuadra që drejton atje janë të rinjtë. Është një Genc Sita fantastik, një djalë i ri, që punon pa u lodhur!

Pyetini banorët jo vetëm atje, por kudo, në Baldushk, në Petrelë, në Dajt, a ka bërë ai diferencime për sa i përket mënyrës së trajtimit të dëmeve që ka sjellë tërmeti? Zero tolerime, zero përjashtime! Nuk u ka kërkuar kartën e anëtarësisë patronazhistëve, ku ju djeg juve, por ka qenë bashkë me to, ka jetuar bashkë me to, i qan hallet bashkë me to. Atje është bërë një rrugë fantastike, Rruga e Arbrit. E kam ftuar kolegen deputete të Matit të shkonim bashkë atje dhe shpresoj të hapet rruga. Aty ka filluar zhvillimi i resorteve. Janë hapur lokale të reja dhe ka mundësi të punësohen njerëz. Nuk ka mbaruar, por do të mbarojë, zonja deputete. Sot e kësaj dite, se unë e kam shtëpinë atje, është shumë e vështirë të kalosh, sepse vijnë dhjetëra e qindra njerëz, të cilët vijnë në Tiranë apo ikin nga Tirana në drejtim të Dibrës apo të Matit.

Pra, ky është realiteti. Kjo është arsyeja pse ju i humbni zgjedhjet. E dini se çfarë ndodh me ju? Është një fakt interesant. Nëse mua më ndalojnë qytetarët dhe më pyesin: "Deputet, çfarë do të bëjmë me këtë rrugën për në Selitë, për në Vilës, për në malin e Vilës, për në Vrap?", e dini se për çfarë ju pyesin juve? "A je me Lulin, apo me Berishën?". Prandaj nuk e kanë besimin ata, që ta çojnë votën dëm, prandaj e votojnë Partinë Socialiste, prandaj e votojnë Edi Ramën. Kjo është arsyeja. Pse kërkoni ta gjeni ju?! E tha, me të drejtë, ministri i Drejtësisë, por zoti Çuçi nuk e kishte mendjen, mirë është të vendosen

bodyguard. Nuk ka arsye, zoti Ministër, të vendosen këta, pasi nuk kemi përse të futemi se çfarë bëjnë këta.

Ne punën e kemi me shqiptarët, pasi ata na votojnë për të qeverisur për interesin e tyre. Për shërbimin online, çfarë të them unë?! Ju ka tmerruar! Nuk ka më radhë, nuk ka më të fusësh lekë në xhep për të kryer shërbimin. Këtë e bën kjo maxhorancë. Ndaj, të nderuar kolegë, shpresoj ta keni votuar këtë ligj, pasi u shërben qytetarëve shqiptarë. Faleminderit!